



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.nr.1/2021

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Shukri Sylejmani dhe Fejzullah Rexhepi anëtarë, në çështjen juridike të paditësve A., I., S., E., Sh. të gjithë M., R. M., N. A., M. K.1, dhe M. K.2, të gjithë nga fsh...., Komuna e K., të cilët i përfaqësojnë Av. Nexharije Hoti dhe Av. Shefki Sylja nga P., kundër të paditurit A. Ll. nga P., të cilin e përfaqëson av. Ramiz Heta nga Prishtina, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, përkitazi me revizionin e paditësve paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4443/14 datë 13.06.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 1.12. 2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i themeltë revizioni i paditësve, prishet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4443/2014 datë 13.06.2019 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.902/08 datë 6.05.2014, ndërsa lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4443/2014 datë 13.06.2019 është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësve dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.902/2008 datë 6.05.2014, me të cilin, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve, kundër të paditurit, me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet se paditësit nga baza e trashëgimisë sipas kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë të dt.10.05.1972, janë bashkëpronar

nga 1/9 pjesë në pjesën e paluajtshëmërisë në ngastrën kadastrale nr. ..., plani dhe skica ½, vendi quajtur “Afër Rrugës”, me sipërfaqe prej 448-m2, e regjistruar në Certifikatën pronësore nr..., ZK-P., me këto përkufizime: prej pikës 1-2, me gjatësi prej 20.72 m, prej pikës 2-3 me gjatësi prej 0.89 m, prej pikës 3-4, me gjatësi prej 21.75 m, prej pikës 4-5, me gjatësi prej 7.21 m, prej pikës 5-6, me gjatësi prej 2.33 m, prej pikës 6-7, me gjatësi prej 6.10 m , prej pikës 7-8 me gjatësi prej 5.42 m, prej pikës 8-9, me gjatësi prej 0.56 m, prej pikës 9-10, me gjatësi prej 23.07 m , ku edhe përfundon përkufizimi dhe që secila palë i heq shpenzimet e veta.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë kanë paraqitur revizion paditësit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni dhe të prishen aktgjykimet e instancave më të ulëta gjyqësore, ndërsa, lënda të kthehet në rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion si dhe shkresave të lëndës, ka gjetur se:

Revizioni i paditësve është i themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se pala paditëse ka paraqitur padi kundër të paditurit më dt.31.05.2004, me të cilën ka kërkuar vërtetimin e së drejtës së pronësisë në pjesën e ngastrës kadastrale nr..., ZK-Prishtinë, në sipërfaqe prej 448 m2, me të dhënat tjera si në petitumin e padisë, përkatësisht si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar. Paraardhësi juridik i paditësve , i ndjeri R. M., ish nga fsh..., Komuna e K., fillimisht ai kishte ngritur padinë e sipër cekur, mirëpo, me qenë se ai , në ndërkohë, kishte ndërruar jetë, paditësit , si më lartë, e kanë precizuar padinë në kuptimin subjektiv, duke u paraqitur ata si paditës në këtë çështje kontestimore. Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar faktin se midis paraardhësit juridik të paditësve, të ndjerit R. M. dhe Sh. B., ka ekzistuar marrëdhënia juridiko-civile- kontrata interne e shitblerjes, e lidhur midis të lartë përmendurve në vitin 1972, e cila edhe është përmbushur, është paguar çmimi prej 3 milion dinarë të atëhershëm, (për pjesën e blerë të ngastrës kontestuese), në prezencën e dëshmitarit H. F., (i ndëgjuar në seancën e dt.10.03.2014). Ky dëshmitar kishte theksuar se kjo tokë ka qenë e H. K., i cili ia ka shitur, një pjesë, vëllaut të paditurit, kurse një pjesë, ia ka shitur H. I. P., kurse, ky më vonë, ia ka shitur Sh. B., ndërsa, pastaj Sh. B. ia ka shitur R. M., paraardhësit të paditësve. Pra, Sh. B., pjesën kontestuese, në të cilën edhe kishte hyrë në posedim më parë, e kishte blerë në bazë

të kontratës interne të shitblerjes nga Hoxhë I. P.. Nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë, gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se ngastra kadastrale nr..., në v.q.” Afër Rrugës”, me kul. shtëpi 55m², oborr 500 m², kulllos 1176 m², me sipërfaqe të tërësishme 1731m², tokë rurale, tipi pronës private, sipas Certifikatës së Pronësisë nr..., ZK- M., evidentohet në emër të A. S.Ll. nga ..., tani me banim në P., në bazë të inqizimit aerofotogrametrik – gjeodezik i vitit 1972, që ka hyrë në fuqi nga v. 1978. Eksperti ka theksuar se nuk ka shënime se kush ka qenë më parë i regjistruar si pronarë i ngastrës në fjalë, i cili, më tej ka shtuar se një pjesë e kësaj ngastre në sipërfaqe prej 480m², shfrytëzohet nga pala paditëse, një pjesë e shfrytëzon vet i padituri, një pjesë rrugë (rruga “...”), dhe një pjesë e shfrytëzonte personi B. B..

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve, kur kanë kërkuar që të vërtetohet se janë bashkëpronarë nga 1/9 pjesë, në pjesën e ngastrës kadastrale, të sipër përmendur, në sipërfaqe prej 448m², është e pabazuar, prandaj, të njëjtën e ka refuzuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të sajë.

Në procedurën ankimore gjykata e shkallës së dytë në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, ndaj, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësve dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, aktualisht nuk mund të pranojë një përfundim të tillë juridik të gjykatave të instancës më të ulët si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aktgjykimet e cekura janë marrë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika (n), ndërsa, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë me shkelje nga neni 182.1 lidhur me nenin 204 të LPK-së dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, e që për pasojë, gjendja faktike ka mbetur pa u vërtetuar në mënyrë të plotë dhe për këtë arsye nuk ka kushte për ndryshimin e tyre, prandaj, për këtë shkak të dy aktgjykimet u deshtë të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Sipas dispozitës së nenit 204 të LPK-së, parashihet se në arsyetimin e aktgjykimit, gjegjësisht të aktvendimit, gjykata e shkallës së dytë duhet t’i vlerësojë thëniet në ankesë që kanë qenë të rëndësishme vendimtare për dhënien e vendimit të saj. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjykata e shkallës së dytë nuk i ka vlerësuar plotësisht thëniet ankimore në kuptim të dispozitës së përmendur.

Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore konsistojnë në atë se ka kundërthënie midis dispozitivit e arsytimit, se arsytimi i aktgjykimit të shkallës së parë nuk përmban arsytet për faktet relevante për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike, arsytet e paraqitura janë të pa kjartha dhe kontradiktore. Nuk ka një analizë të provave të zhvilluara nga gjykata e shkallës së parë në kuptim të nenit 8 të LPK-së,(ekspertizës së gjeodezisë, dëshmitarve, kqyrjes në vend, shkresave tjera të lëndës),nuk janë vënë në relacion krahasues dhe vlerësues, veç e veç e së bashku.

Kështu,shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore qëndron në faktin se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetvete dhe me arsytet e tij, sepse, nuk është bërë identifikimi i sigurt dhe i plotë i pjesës së ngastrës kontestuese, nuk janë përshkruar saktë kufijtë e pjesës së ngastrës kontestuese, si dhe me të cilat ngastra kadastrale kufizohet pjesa e ngastrës kontestuese (mungon përkufizimi, shtrirja, veri, jug, perëndim, lindje, me masat përkatëse, gjatësi, gjërësi).

Përveç, kësaj që u sipër theksua, nuk janë dhënë arsytet e plota, bindëse dhe ligjore përkitazi me faktet relevante për vendosjen e drejtë dhe ligjore të këtij rasti juridiko- civil, pra, kur saktë është blerë pjesa e ngastrës kontestuese, me cilat masa dhe kufijë, me cilën sipërfaqe, nga kush është blerë, prej kujt është blerë, pagesa e çmimit shitblerës, kush e ka shfrytëzuar nga v.1972, kush dhe si e shfrytëzon aktualisht, a e shfrytëzon pala paditëse sipërfaqen prej 448m², si dhe në ç'mënyrë është regjistruar në emër të paditurit, sipas cilës bazë juridike a mënyre të fitimit (iustus titullus- modus aquirendi), si ka qenë e regjistruar më parë, para inqizimit aerofotogrametrik(1972-1978), në emër të kujt, nuk shihet se çka ka konstatuar gjykata e shkallës së parë nga zhvillimi i provës materiale, këqyrja në vend (nga se në arsytim fare nuk e përmend) etj, për këto rrethana e fakte relevante nuk ka deklarim dhe konstatim përkatës të gjykatave të instancës më të ulët.

Në bazë të dispozitës së nenit 253.2 të LPK-së, Gjkata nuk është e lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë. Ajo do të veprojë sipas padisë edhe kur paditësi nuk e ka treguar bazën juridike të kërkesëpadisë (neni 253.3 i LPK-së). Prandaj, nga këtu, gjykata me rastin e vendim marrjes, duhet të ketë parasysh, veç tjerash, edhe dispozitat e nenit 20, nenit 28 etj, të LMTHPJ-së. Ndërkohë që, vlen të theksohet se në aktgjykimin, përkatësisht, në arsytimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, nuk përmendet asnjë dispozitë ligjore, në të cilën ajo ka bazuar vendimin e vet. Nuk qëndron as konstatimi i gjykatës së shkallës së parë, përkitazi me mungesën

e legjitimitetit pasiv të paditurit, kjo nga se, sipas ligjit, për palën përkatëse, thuhet se ka legjitimitet real aktiv ose pasiv, nëse ajo palë, është pjesëmarrëse e raportit materialo- juridik nga i cili lind kontesti, sikundër edhe është rasti konkret, kur nga arsyet e sipër theksuara, legjitimitetin real pasiv e ka i padituri, ndërsa, legjitimitetin real aktiv e ka pala paditëse.

Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar si të bazuara thëniet e revizionit, që kanë të bëjnë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182.2 pika (n) në lidhje edhe me nenin 204 të LPK-së dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale nga neni 184 i LPK-së.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë është e detyruar të mënjanojë të metat e lartcekura, t'i vlerësojë të gjitha provat duke i vënë në relacion krahasues, veç e veç dhe së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me qëllim që të vërtetojë të gjitha faktet relevante të sipër përmendura, të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, nga ana e ekspertit - ekspertëve të gjeodezisë të kërkojë historiatin e plotë të ngastrës kontestuese, respektivisht, të pjesës së saj, shënimet kronologjike kadastrale, prej kadastrit përshkrues (1952) e deri tek aerofotografimi dhe aktualisht, në emër të kujt evidentohej më parë, si është bërë transformimi i pronës, duke vërtetuar edhe faktet e rrethanat si më lartë, si dhe duke pasur parasysh edhe thëniet tjera në revizion, të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Në bazë të asaj që u theksua e në mbështetje të dispozitës së nenit 223.1 dhe nenit 224.2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.1/2021 datë 1.12. 2021

Kryetar i kolegjit,
mr.sc. Muhamet Rexha

